

LETËRSIA 11



LETËRSIA 11

Për shkollën e mesme të përgjithëshme





PËRMBAJTJA

Hyrje 6

Si ta përdorim këtë libër 7

I GJINITË DHE LLOJET LETRARE 10

1. GJINITË LETRARE	10
Karakteristikat e gjinive	12
Poezia epike	13
Llojet e poezisë epike	15
Ligjërimi poetik	17

2. NJËSITË E KUPTIMSHME TË TEKSTIT LETRAR	22
Tropet	22
Si ndërtohet një figurë?	23
Metafora, kalimet metaforike	26
Metonimia, kalimet metonimike	29
Alegoria	33
Krahasimi. Antiteza	34
Hiperbola. Litota. Grotesku	38
Ironia, sarkazma, paradoksi	40
Figurat e sintaksës poetike	44

3. AUTORI DHE RRËFIMTARI	48
Gjuha e shkrimtarit	49
Gjuha e autorit	49
Gjuha e rrëfimitarit	50
Gjuha e personazhit	51

4. SUBJEKTI DHE FABULA	52
Parashtrimi ose ekspozicioni	53
Intriga	55
Fabula	55

5. KOHA LETRARE DHE KOHA E LIGJËRIMIT	56
Koha letrare	57
Koha e ligjërimit	58

6. PERSONAZHI. SISTEMI I PERSONAZHEVE	60
Karakterit	60

7. LEXIMI I TEKSTIT LETRAR	63
----------------------------	----

8. KONTEKSTI HISTORIKO-LETRAR	66
-------------------------------	----

9. KODET LETRARE	72
------------------	----

II ROMANTIZMI 78

1. TIPARET KRYESORE TË ROMANTIZMIT	78
Përfaqësuesit kryesorë të romantizmit anglez	78
Përfaqësuesit kryesorë të romantizmit francez	79
Romantizmi	80

2. JOHAN VOLFGANG GËTE	83
Jeta dhe vepra	83
Fausti	85
Koment letrar nga "Fausti"	89

3. XHORXH GORDON BAJRON	92
Jeta dhe vepra	92
Shtegtimet e Çajld Haroldit	95
Arti i Bajronit	98
Koment letrar nga "Shtegtimet e Çajld Haroldit"	99

4. VIKTOR HYGO	103
Jeta dhe vepra	103
Shën Maria e Parisit	106
Arti i Hygoit	109
Koment letrar nga "Shën Maria e Parisit"	110

5. RILINDJA KOMBËTARE SHQIPTARE. ROMANTIZMI SHQIPTAR 114

6. JERONIM DE RADA	122
Jeta dhe veprat	123
Këngët e Milosaos	124
Koment letrar nga "Këngët e Milosaos"	127

7. NAIM FRASHËRI	130
Jeta dhe veprat	132

8. POEZIA E NAIMIT	136
Lulet e verës	136

III REALIZMI 158

1. TIPARET KRYESORE TË REALIZMIT	158
-------------------------------------	-----

2. HONORE DË BALZAK	160
Jeta dhe vepra	160
Komedia njerëzore	162
Xha Gorio	163
Pikëpamjet dhe arti	164
Koment letrar nga "Xha Gorio"	165

3. GUSTAV FLOBER	168
Jeta dhe vepra	168
Zonja Bovari	170
Arti i Floberit	171
Koment letrar nga "Ema Bovari"	172

4. FIODOR DOSTOJEVSKI	176
Vëllezërit Karamazovë	178
E veçanta Dostojevskiane	180
Koment letrar nga "Vëllezërit Karamazovë"	181

IV SIMBOLIZMI 158

1. TIPARET KRYESORE TË SIMBOLIZMIT	188
---------------------------------------	-----

2. EDGAR ALLAN POË	190
Korbi	191

3. POL VERLENI	192
Jetimi	192

4. SHARL BODELERI	193
Jeta dhe vepra	193
Lulet e së keqes	195
Koment letrar nga "Lulet e së keqes"	197

HYRJJE

NATYRA E LETËRSISË

Letërsia, për nga natyra e saj, i rrëshqet përkufizimeve të sakta, po aq sa përmbledh një sërë tiparesh e veçorish, që kanë të bëjnë sa me natyrën e thelbin e saj, po aq edhe me funksionet që ajo kryen.

Letërsia është një nga veprimtaritë krijuese, që e ka shoqëruar historinë e njerëzimit që në lashtësi.

Ajo është pjesë përbërëse e jetës së përditshme.

Termi letërsi e ka zanafillën nga fjala *littera*/turë (latinisht, *littera* - shkronjë), duke sugjeruar për letërsinë diçka të shkruar.

Në periudhën antike me literaturë emërohej gjithçka e shkruar, qoftë kjo letërsi ose jo. Por letërsia nuk është vetëm ajo që është e shkruar në libra, sepse përveç letërsisë së shkruar, që në të vërtetë përbën pjesën më të madhe të saj, ekziston edhe letërsia gojore.

Letërsia gojore nuk është vetëm ajo që është përhapur dhe transmetuar në kohët kur pak njihej shkrimi (ajo që njihet si letërsi popullore), por edhe ajo që krijohet e qarkullon gojarisht sot, në kohët moderne.

THELBI I LETËRSISË

Për të kuptuar natyrën e letërsisë, duhet të shkojmë drejt thelbit të saj. Nocioni letërsi aristike, shpreh dallimin mes veprave shkencore dhe veprave letrare, në kuptimin e ngushtë të fjalës.

Dallimi themelor qëndron në faktin se shkenca i qaset objektit të saj me metoda të posaçme shkencore, për të nxjerrë ligje dhe rezultate gjithëvlerëshe.

Letërsia nuk i afrohet objektit të saj me metoda specifike. Qëllimi i saj nuk është nxjerrja e ligjshmërive, por rikrijimi i botës dhe i njeriut, si dhe formësimi i tyre në mënyrë *fiksionale* (trilluese), pra artistike.

Letërsia pra është arti i fjalës, sepse gjuha është mjeti përbërës i saj.

Nëpërmjet gjuhës letërsia ndahet nga artet e tjera, që kanë mjete të tjera përbërëse (për shembull.: notat e tingujt për muzikën, ngjyrat për pikturën, etj.). Por, edhe kjo nuk do të thotë se të gjitha tekstet e shkruara, janë letërsi.

Gjuha e figurshme e bën letërsinë që të jetë e tillë, që të dallojë nga të gjitha llojet e tjera të të shkruarit.

Letërsia luan më fjalën.

Synimi i saj nuk është të shënjojë objektin drejtpërdrejt, por, duke e veshur fjalën me figuracion, me kuptime të dyta, të treta, e më tej me kuptime simbolike e alegorike, me ngarkesa emocionale dhe me kuptime që dalin prej asociacioneve të ndryshme, letërsia e shënjon me saktësi objektin, me larmi «dojërash» e kombinimesh. të ndryshme.

Shpesh, sidomos në letërsinë moderne, kuptimi i veprës përftohet duke zbrëthyer figuracionin ose duke e përmbysur kuptimin e parë të shprehjes gjuhësore. Pra, letërsia funksionon vetëm nëse krijimtarinë letrare, pra veprat artistike i lexojmë si të tilla.



Si ta përdorim këtë libër

Kriteri parësor i tekstit është kriteri tematik, zhvillimi i kompetencave, i ndërthurur natyrshëm me kriterin e gjinisë letrare.

Njësitë mësimore zbërthehen në:

- tematika dhe çështje mësimore;
- në përdorimin e sa më shumë burimeve alternative, tradicionale dhe multimediale;
- në lirinë dhe krijimtarinë e planifikimit dhe realizimit të njësisë,
- në fleksibilitetin e përcaktimit dhe shpërndarjes së orëve midis njësive mësimore dhe brenda njësive,
- në përzgjedhjen nga mësuesi dhe vetë nxënësi të veprimtarive të nxënies më të përshtatshme për arritjen e kompetencave;
- në integrimin e natyrshëm, jo vetëm të lëndës

së letërsisë me gjuhën, por edhe me lëndë të tjera ndërmjet lidhjes, referimit, demonstrimit të njohurive, shprehive dhe aftësive

- në kontekstin e analizës së thelluar të veprës letrare dhe parashtrimeve individuale me gojë dhe me shkrim të nxënësit.

Do të përdoren lami aktivitete ndërevepruese, nga parashtrimet dhe diskutimet në grup deri tek proceset e të shkruarit

Libri e ndihmon nxënësin të zhvillojë aftësitë e të menduarit kritik, të reagojë bindshëm për atë që lexon. Nëpërmjet diskutimit në grup libri nxit shprehitë e zgjidhjes së problemit dhe të vendimmarrjes.

Detyra interpretuese - me shkrim bazuar në letërsi. Diskutime të gjalla - në grup: për autorin, veprat letrare dhe burimet mbështetëse e tij.





I. GJINITË dhe LLOJET LETRARE



1. GJINITË LETRARE

Klasifikimi i veprave letrare sipas gjinive dhe llojeve letrare është detyra më e vështirë, njëkohësisht edhe më e rëndësishme e letërsisë. Çdo vepër letrare lexohet dhe studiohet brenda gjinisë dhe llojit të cilit i përket. Historia e letërsisë dëshmon se gjinitë dhe llojet letrare mund të ndryshojnë e të gërshetohen, por disa parime të përgjithshme mbi ndërtimin e tyre mbeten. Një vepër letrare mund t'i përkasë një gjinie, por edhe dy, madje dhe tre formave themelore të shprehjes letrare. Për shembull, “Kënga e sprasme e Balës”, është vepër epiko-lirike, ndërsa “Këngët e Milosaos”, është vepër liriko-epike. Megjithëse “Lahuta e malcis”, është vepër epike, në këtë poemë ka këngë të mrekullueshme lirike si: Tringa.

Në këtë këndvështrim, epika, lirika dhe dramatika, teorikisht janë kategori ideale të shprehjes letrare. Teoritë mbi gjinitë letrare mbështeten në idenë se ekzistojnë disa mënyra





themelore të shprehjes letrare ose disa tipe marrëdhëniesh poetike, ndaj botës dhe jetës. Nga Aristoteli e Platoni, te Emil Shtajgeri, te Gëte e Jakobsoni, këto tri gjini janë parë si format themelore të “natyrshme” të letërsisë.

Me gjini letrare kuptojmë një grup veprash, që kanë të përbashkët një sërë tiparesh të jashtme të ndërtimit formal (si: vargu, metri, struktura, etj.) dhe të anës së brendshme (si: mesazhi, tema, përmbajtja, etj.).

Filozofi grek Aristoteli, në veprën e tij “Poetika”, bën ndarjen dhe dallimin midis dramës, epikës dhe lirikës. Këto kategori themelore janë ndarë sipas “mënyrës së imitimit” ose paraqitjes së realitetit. Dy gjinitë themelore më të mëdha ndahen në *tragjedi* dhe *epos*. Diomedi, në shekullin IV, duke sistemuar teorinë e Platonit, propozoi përkufizimet: *lirikë* - veprat ku flet vetëm autori; *dramatikë* - veprat ku flasin vetëm personazhet; *epikë* - veprat ku autori dhe personazhet kanë njësoj të drejtë fjale. Sipas mendimit të Shtajgerit, në themel të lirikës, epikës, dhe dramatikut është ligjërimi i një stili të caktuar. Stilit lirik i referohet harmonia midis muzikës e fjalëve, kuptimit të tyre. Lirika i afrohet muzikës dhe cilësia e saj themelore është mënyra e shprehjes, në të cilën zhduken ndryshimet midis individit dhe botës, midis objektivitetit dhe subjektivitetit. Epikë i përket objektiviteti dhe gjerësia e të rrëfyerit, që realizohen në përshkrimin e një bote të caktuar. Dramatika mbështetet në konfliktin midis dy qendrimeve të individëve, në konfliktin midis asaj që është dhe asaj që duhet të jetë. Epika, lirika dhe dramatika, sipas poetit Shtajger, u përgjigjen: ndjeshmërisë, figurshmërisë dhe logjikës. Ai bën një interpretim thelbësisht kohor të gjinive, duke vendosur raportin: lirikë - e tashme; dramatikë - e ardhme. Po ashtu ai lidh kategori të tilla si: hutimi, me lirikën; vështrimi i tërësisë : me epikën; tensioni: me dramatiken.

Shkrimtari i madh Gëte pohon se... “Ka vetëm tri forma të natyrshme autentike të poezisë: ajo që tregon qartë; ajo e emocionit të ekzaltuar; ajo që preokupohet me subjektiven-epopeja, poezia lirike, drama. Kjo formulë i referohet tre formave kryesore të të shprehurit: ai (epope), unë (poezi lirike), ti (dramë). Kjo gjë ndeshet te gjuhëtari dhe poeti Jakobson, për të cilin “pikënisja dhe tema drejtuese e poezisë lirike janë veta e parë dhe koha e tashme, ndërsa e epopesë janë veta e tretë dhe koha e shkuar. Filozofi Hegel e ndërlidh lirikën me të shprehurit e subjektivitetit, epikën me objektivitetin, ndërsa





dramatikën e konsideronte si sintezë të të dyjave.

Teoria e tri stileve, i lartë, i mesëm, i ulët, ngjitet në Mesjetë. Për ilustrim zakonisht shërbejnë veprat e Virgjilit, përkatësisht: “Eneida”, “Gjeorgjikat”, “Bukolikat”.

Nga njëra anë, bëhet fjalë për zgjedhjen e leksikut, të ndërtimeve sintaksore, nga ana tjetër, për zgjedhjen e objektit të përshkrimit, për shkallën sociale të personave të paraqitur (luftëtarë, fshatarë, barinj). Ky dallim është pra njëherësh letrar (gjuhësor) dhe sociologjik. Që nga romantizmi ky lloj klasifikimi nuk përdoret më. Brenda kësaj tipologjie, çdo gjini ndahet në grupe të tjera më të vogla, që pastaj ndahet përsëri në lloje letrare të veçanta. Kështu, për shembull, epika ndahet në *epikë në prozë* dhe në *epikë në vargje*.

●●● KARAKTERISTIKAT E GJINIVE

Çdo gjë e shkruar në vargje, pavarësisht nga përmbajtja, konsiderohet letërsi. Këtu bën pjesë jo vetëm poezia lirike ose ajo epike, por edhe e ashtuquajtura poezi didaskalike, pra ajo që i trasmeton lexuesit një tërësi njohurish të disiplinave: shkencore, teknike, filozofike etj.

Me lindjen e poezisë përcaktohen zanafillat e letërsisë botërore. Fillimisht poezia ishte vetëm mënyrë tjetër e organizimit të gjuhës së përditshme. Sekret i atyre që krijojnë poezi ishte dhuntia për të zgjedhur fjalët më të efektshme, për t'i pranëvënë ato fjalë në mënyrë tingëlluese, për t'i organizuar ritmikisht. Pak a shumë këto veçori artistike poezia i ruan dhe në kohët e sotme, megjithëse edhe proza e shfrytëzon organizimin poetik të gjuhës.

Dallimi formal i poezisë duket te paraqitja e saj grafike. Madje eksperimentet moderniste shpesh kërkojnë edhe paraqitjen grafike të vargjeve, deri imitimin e imazheve gjithfarëshe, si: pikat e shiut, siluetat e njerëzve e të objekteve të tjera.

Ashtu si në historinë e letërsisë botërore, në historinë e letërsisë shqiptare, provat e para poetike i takojnë poetëve anonimë, që krijuan vargje ritualesh, këngësh argëtuese e poemash të gjata epike. Orfeu mitologjik përcjell deri në ditët tona përfytyrimin e hershëm të poetit mrekullibërës. Qytetërimeve të hershme u përkasin poetët e parë që përfaqësojnë artistët e fjalës poetike. Çdo epokë historike dhe kulturë e dokumentuar me shkrim ka plejadat e veta të poetëve, që krijojnë panteonin botëror

përbërëse të strukturës së poezisë epike.

Fabula ka të bëjë me tërësinë e ngjarjes, nga fillimi deri në fund. Ato janë ngjarje të njohura e të rëndësishme nga e kaluara historike dhe mitologjike e popullit, ndërsa personazhet janë kryesisht heronj, që përfaqësojnë cilësitë më të mira të popullit për të cilin bëhet fjalë. Shpesh, poezia epike merr lëndë nga mitologjia dhe historia. Kështu, për shembull, “Lahuta e malcis”, e Gjergj Fishtës, i strukturon ngjarjet e personazhet në tre nivele: mitologjik (si: orët, zanat), historik (ngjarje të tilla si: Konferenca e Londrës, Lidhja e Prizrenit) ose personazhe (si: Oso Kuka, Abdyl Frashëri) dhe trillues (si personazhet e Tringës e të Patër Gjonit.).

Epika përshkruan ngjarje të mëdha, që sillen rreth temave të rëndësishme. Poemat homerike merren me luftën greko - trojane, Eneida me formimin e popullit të ri latin dhe të shtetit të Romës, “Lahuta e malcis” - rrëfen çlirimin e trojeve shqiptare dhe formimin e shtetit shqiptar.

Lexuesit dhe dëgjuesit, nuk kanë interes vetëm për rezultatin e ngjarjes, por edhe për rrjedhat dhe ecurinë e saj.

Në poezinë epike, është e veçantë mënyra e futjes në ngjarje. Duke qenë ngjarje e rëndësishme dhe e njohur, rrëfimtari bën një hyrje të shkurtër dhe e fillon rrëfimin *in medias res* (lat., në mes të ngjarjes). Shembull tipik për këtë është “Iliada”, ku thërrihen perënditë për ndihmë dhe parashtrohet tema (shih vargjet më poshtë).



●● LLOJET E POEZISË EPIKE

Epet janë në themelet e letërsive të reja, megjithëse vijnë nga një traditë komunikimi gojor. Dallohet epika gojore dhe epika e shkruar.

Epi gojor lidhej drejtpërdrejt me atë që e këndonte. Në Shqipëri, në zonat veriore të vendit, Këngët e Kreshnikëve këndohen duke u shoqëruar me lahutë prej rapsodësh të talentuar, të cilët na kanë dhënë këngë me 500 deri 700 vargje (si: “Kënga e Ymer Agës”, “Kënga e Halil Garrisë”, “Kënga e Gjergj Elez Alisë”). Epika e shkruar ruan ende sot elementin këngë. Mjafton të kujtojmë që “Kënga e Sprasme e Balës” e Gavril Darës së Ri, “Historia e Skënderbeut” e Naim Frashërit, “Lahuta e malcis” e Gjergj Fishtës, përbëhen nga një numër i



shpirtërore, e ndjenjave dhe përjetimeve, mbresat e perceptimi vetjak për ngjarjet e njerëzit, shpesh nën ndikimin e një shtyese të brendshme të ndezur me hov, me pjesëmarrje subjektive, ku edhe mjedisi, përshkrimet e portretet dalin me disa penelata të shpejta, më tepër si përshtypje.

Nga ana stilistike ligjërimi mbështetet te epitetet e hareshme, te fjalët poetike, te neologjizmat, ndërtimet sintaksore të lehta pa shumë lidhëza, madje shpesh me elipsa, me ndërprerje, me heshtje, me rimarrje të shoqëruar me muzikalitetin, përmendur edhe më lart.

Proza e shkruar me mjetet lirike të poezisë, quhet *prozë poetike*. Në këtë rast edhe proza synon një farë muzikaliteti, një ritëm të brendshëm ndërmjet grupeve të gjera ligjërimore, një valëzim sintaksor të perceptueshëm.

Tradita popullore dhe e shkruar e vjershërimit, përbën *kulturën poetike shqipe*. Ajo është pasuri e letërsisë sonë, që përtërihet dhe zhvillohet më tej nga krijuesit më të mirë, me talent e ndjeshmëri poetike, por që edhe e njohin teknikën e vjershërimit, si kombëtare, ashtu dhe ndërkombëtare, në përputhje me natyrën e gjuhës shqipe.

●● Pyetje

1. Cila është veçantia e poezisë epike? Po ligjërimi poetik?
2. Cili është parimi themelor i organizimit poetik?
3. Çfarë e dallon poezinë nga proza?
4. Përse vjershat shkruhen në vargje?
5. Çfarë lidhesh ka poezia me muzikën?

●● Ushtrime

1. Lexoni radhët e mëposhtme nga Fan Noli.

Si i shpjegon ai personazhet? Çfarë dini tjetër për këto personazhe? Tregoni ngjarjen me fjalët e tuaja.

Bruti dhe Kasi përfaqësojnë dy shkolla politike, dy sisteme revolucionare krejt të ndryshme sa për methodën që duhet vazhduar për t'arritur në liri me sukses. Janë plotërisht në një mendje që çapi kryesor, domethënë rrëzimi i regjimit tiranik, duhet bërë me çfarëdo mjet pa mëshirë e pa skrupulla morale.



2. Në vargjet më poshtë, të poetit të mirënjohur Lasgush Poradeci, përpikuni të gjeni të gjitha mjetet tingullore të përputhura me imazhin poetik:

*rënia e natës dhe e heshtjes,
qetësimi i gjithë jetës dhe udhëtimi thellësive. ..*



Poradeci

*E kudo krahin' e gjerë më s'po qit as pipëllim:
Në Katund kërcet një portë... në Liqer hesht një lopatë...
Një shqiponjë e arratisur fluturon në Mal-të-Thatë...
Futet zemra djaloshare mun në fund të shpirtit tim.
Tërë fisi, tërë jeta, ra... u dergj... e zuri gjumi...
Zotëroj më katër anët errësira...*

Po tashi:

*Dyke nisur udhëtimin mes-për-mes nër Shqipëri,
Drini plak e i përrallshëm po mburon prej Shëndaumi...*

3. Dy strofat e para të poezisë së Ndre Mjedës


“Mahmud Pasha në Mal të Zi”, -

janë kushtrim i mirëfilltë i gojëtarit, vetëm se
treguar e veshur në petkun e vargjeve.

Përpikuni t'i përcaktoni konkretisht këto mjete
në vargjet më poshtë:

*M'kam, o Shkodrë, o nan' e drangojve,
Lé prei grykes t'martinës, prei çelikut!
Maje bjeshkve, nder shqype, e n'fund t'shtojve,
Ku buqari shqypar avullon.*

*Qit kushtrimin: O Lekë, kundra anmikut
Me një hov, me një zemrë permbledh'n'ju;
Pertë Cemin si 'j nieri tanë hidh'n'ju;
Shqypartija, o fatosa, ju fton.*



4. Çfarë gjendje shpirtërore është përpjekur të japë poeti Jeronim De Rada, me këto fjalë të Serafinës:

*Nuk ka pak e m'u hoq syvet
një si perde e në çast pashë
gjithë gëzimet që kam patur
çupë, vashë e nuse-zonjë,
që në gjë dhe më kanë vdekur
si e djeshmja vdes në gjumë
tok me botën e kaluar.
Që të gjitha bashkë m'u shfaqën
si faqe përjtësie
që tashmë po më hap Ora...*

*Pastaj një erë në mbrëmje
shtyu e fshiu retë e qiellit,
sikur desh diçka të fshinte
edhe nga shtëpitë mbi dhe.
Dhe drita që u shkri pa u ndierë,
shkoi pa u ndierë se vdiq zonja
që na la vetëm shëmbëllesën
mëndje-e-fjalë-shkëlqimtare!*

